



Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-067, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të datës 21 maj 2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-034.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës ka jurisdikcion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.



Parashtrimi i ankesave duhet të bëhet brenda afateve të parapara ligjore, përndryshe ankesat nuk do të shqyrtohen.



## AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Rruga "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë,  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

T: +383 (0) 38 500 400

E: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Kualifikueshmëria  
e punëtorëve për të  
drejtën në 20%

## A KUALIFIKOHENI PËR 20%?

1. A jeni apo keni qenë i regjistruar si punëtorë i ndërmarrjes në kohën e privatizimit?
2. A keni qenë në listën e pagave për jo më pak se tri (3) vite?
3. A keni prova se ju apo personi në emër të cilit aplikoni do të ishit/te i/e regjistruar si punëtor/e e ndërmarrjes nëse nuk do të ishit të diskriminuar (psh. ish punëtori ishte i vrare në luftë)?

*Nëse përgjigja juaj është "PO" në tri pyetjet e lartcekura dhe nëse si ish-punëtor nuk keni arritur moshën e pensionimit deri në datën e privatizimit, likuidimit apo shpronësimit të NSH-së, atëherë ju kualifikoheni për të qenë në listën e përfutuesve të fondeve të 20%-it.*

## LISTAT FILLESTARE

Hartimi i listës fillestare bëhet në përputhje me nenin 10.1 dhe 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Reg. 2004/45, që do të thotë se hartohet nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, në baza jo diskriminuese dhe i dërgohet Agjencisë për shqyrtim dhe publikim. Komisioni për shqyrtimin e listave të 20%-it në AKP, bën ndryshimet e nevojshme në listë për t'i dhënë qasje të barabartë të gjithë punëtorëve dhe të njëjtën e publikon.

Nëse konsideroni se keni plotësuar kushtet e kualifikueshmërisë por emri juaj nuk gjendet në listë, apo mendoni se duhet të kundërshtoni një apo më shumë emra të përfshirë në listë, ju mund të ushtroni ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave ndaj listave fillestare në AKP, në afat prej 20 ditësh nga dita e fundit të publikimit të listës fillestare.

## LISTAT FINALE

Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj listave fillestare të punëtorëve shqyrtton ankesat e parashtruara dhe harton Listën përfundimtare të punëtorëve, e cila së bashku me shpërndarjen e parakohshme të fondeve të 20%-it aprovohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Ndaj Listës Përfundimtare, punëtorët e pakënaqur kanë të drejtë ankesë në afat prej 20 ditësh nga dita e fundit të publikimit të listës përfundimtare, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKP-në. Për çdo ankues pranë Dhomës së Posaçme rezervohen mjetet e 20%-it në rast se ankesa e tyre aprovohet me vendim final.

## FONDET

Fondet e 20%-it shpërndahen menjëherë pas konfirmimit të numrit të ankesave nga Dhoma e Posaçme punëtorëve të kualifikuar, emrat e të cilëve kanë qenë të përfshirë në Listën Përfundimtare.

Shuma e fondeve në dispozicion për t'u shpërndarë transferohen në një llogari të veçantë në BSPK, në përputhje me nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime). Me këtë rast nga shuma totale e 20%-it, punëtorëve i shpërndahet 90%-shi i 20%-it e cila quhet shpërndarja e parakohshme, gjersa 10%-shi mbetet si fond rezervë i cili shpërndahet 6 muaj pas vendimit final të Dhomës së Posaçme, për ndonjë ankesë të suksesshme/korrigjim të stazhit të punës

Në fazën e përgatitjes së shpërndarjes së parakohshme punëtorët e kualifikuar duhet të dërgojnë në BSPK një kopje të letërnjoftimit dhe konfirmimin e një llogarie bankare aktive (e cila nuk është e pensionit). BSPK pas kompletimit të të dhënave të nevojshme nga ish punëtorët fillon me shpërndarjen e fondeve në llogari individuale të punëtorëve.

Duke filluar prej vitit 2004 deri në mes të vitit 2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka arritur të shpërndaj shumën prej **€157,419,036.50** tek punëtorët e kualifikueshëm për 20%.

